



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 635 / Prot. 10

Vlorë, më 11.02.2025

VENDIM

Nr. 13, datë 11.02.2025

PËR


MIRATIMIN E PROÇEDURËS

PËR PËRMIRËSIMIN E NOTËS NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI"

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Referuar Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë miratuar me Vendim Senati Akademik nr.20, datë 11.04.2022 "Për miratimin e rregullores së brendshme të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë si dhe referuar Vendimit Nr.2 të Rektoratit, datë, 28.01.2025 Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën në lidhje me mënyrën dhe mundësinë e përmirësimit të notës për studentët e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, të cilët janë vlerësuar njëherë për dijet e tyre, si më poshtë vijon:
 - a) Studentët të cilët ndjekin ciklin dhe e parë ciklin e dytë të studimeve kanë të drejtë të kërkojnë përmirësimin e notës deri në dy lëndë të çdo viti akademik.
 - b) Këto përmirësime bëhen vetëm në Riprovimet e sezonit të Vjeshtës ose Riprovimet e sezonit të Janarit.
 - c) Kërkesa për përmirësim note paraqitet nga studenti pranë Sekretarisë Mësimore, e cila e përcjell informacionin tek Sektori IT-së për të bërë të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit.
 - d) Kërkesa për përmirësim note paraqitet jo më vonë se një javë para fillimit të sezonit të Riprovimeve. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e një lënde jo më shumë se një herë.
 - e) Për përmirësim note studenti testohet vetëm një herë dhe mbetet në fuqi nota më e lartë midis asaj të mëparshme dhe asaj me të cilën studenti vlerësohet në fund.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- f) Nëse studenti ka bërë kërkesë për përmirësim note dhe nuk paraqitet për provim, mbetet në fuqi nota e mëparshme.
 - g) Në rastin e organizimit të lëndëve me module, ku vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara ose shlyrjes së lëndës me pjesë, përmirësimi i notës bëhet për të gjithë lëndën.
 - h) Studentët tërheqin pranë zyrës së studentit faturën përkatëse për këtë shërbim dhe mënyra e pagesës dhe dorëzimit të faturës në institucion, dotë jetë e njëjtë siç veprohet me faturat e tarifave të studimit.
2. Senati Akademik propozon pagesën për këtë shërbim në masën 1000 lekë për kredit.
 3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AURELA SALIAJ

